

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Adnan Konushevc, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. H. R. nga P., Rruga "...", p.n, kundër të paditurës Ndërmarrja Zejtare dhe Banesore "B." në P., Zona I., p.n, me objekt kontesti, vërtetim kontrate, ne shqyrtimin kryesor te mbajtur më datë 15.03.2016, ne prezencën e palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

AKTGJYKIM
- NË BAZË TË POHIMIT -

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit M. H. R. nga P., Rruga "...", p.n, **SI E BAZUAR**, dhe **VËRTETOHET** se paditësi është pronar i banesës e cila gjendet në P., Lagja B. D., Rruga -...-, Lamella .., Kati -...-, banesa numër .., në sipërfaqe prej 82,72 m², në bazë të kontratës mbi bashkimin mjeteve për ndërtimin e banesave, me numër *numri...*, datë 27.02.1998, **DETYROHET** e paditura Ndërmarrja Zejtare dhe Banesore "B." në P., që paditësit të ia njohë këtë të drejtë dhe te lejoj paditësin që në librat respektivisht te regjistrohet si pronar i kësaj paluajtshmerie, krejt kjo në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit, gjatë shqyrtimit kryesor kanë ngelur në tërësi pranë pohimeve në padi dhe ne kërkesëpadi dhe ka kërkuar nga gjykata që ta detyron te paditurën Ndërmarrja Zejtare dhe Banesore "B." në P., me seli në P. që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimi ti mundësohet vërtetimi i kontratës me numër *numri...*, datë 27.02.1998, mbi bashkimin e mjeteve për ndërtimin e banesës e cila gjendet në P..., Lagja B. D., Rruga -...-, Lamella .., Kati -...-, banesa numër .., në sipërfaqe prej 82,72 m², me propozim për gjykatën që të njëjtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

I padituri, si në përgjigje në padi ashtu edhe ne fjalën përfundimtare, ka pranuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Mëtej përfaqësuesi i të paditurës në përgjigje në padi ka

theksuar se paditësi ka kontratë me të paditurën dhe me kohë i ka përmbushur të gjitha obligimet financiare që rrjedhin nga kontrata me numër *numri...* e datës 27.02.1998, për blerjen e banesës, prandaj paditësi është pajisur me Vërtetimin me numër .., të datës 29.04.2011, me të cilin vërtetohet se paditësi i ka përmbushur të gjitha obligimet ndaj të paditurës dhe vërtetimi i lartpërmendur paditësit i vlen për bartjen e pronësisë, prandaj padinë nuk e kundërshtojmë por e pranojmë në tërësi si të bazuar.

Andaj gjykata pasi i vlerësoi pohimet e palëve ndërgjyqëse, duke mos u lëshuar fare në shqyrtim të mëtejme, ka marrë aktgjykim në bazë të pohimit konform nenit 148 par.1 dhe 148 par.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marr konform nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

C.nr.1548/11 të datë 16.03.2016

Gjyqtari,

Adnan Konushevci

KESHILLA JURIDIKE:

Konform nenit 177 të LPK-së, palët ndërgjyqëse kanë heqë dorë nga e drejta e ankesës, ky aktgjykim më datën e marrjes, më 16.03.2016, bëhet i plotë fuqishëm.